

TË MËSUARIT E ÇËSHTJEVE MË TË RËNDËSI SHME

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

E falënderoj Allahun për të mirat e Tija dhe i qoftë falemnderimi për mirësitë e Tija. Dëshmoj se nuk ka askush që meriton adhurimin, përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka shok. Vetëm Atij i takon gjykimi në Tokën e Tij dhe Qiejt e Tij. Dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij, vulë e të Dërguarve të Tij. Ai e ka dërguar atë pas kohës së mosardhjes së Pejgamberëve dhe me të e ngriti të vërtetën dhe i udhëzoi krijesat, ashtuqë rruga u bë e qartë dhe me këtë u u ngrit/vendos argumenti. Salavati dhe salami qofshin mbi të, familjen e tij dhe gjithë shokët e tij...

Pastaj:

Duke pasur parasysh se Tewhidi është baza e të gjithë bazave dhe fillimi i thirrjes së të gjithë pejgamberëve, shpirti i të gjitha librave qiellorë, thelbi i të gjithë teksteve pejgamberike dhe cilësive të të folurit të tyre, disa vëllezër të etshëm për dituri dhe mësimin e saj m'u lutën që të përgatis një përmbledhje për Tewhdin në të cilën do të mblidhja bazat dhe rregullat e tij, duke përmendur argumente, që do t'u ndihmonte Muwehhidëve të fitojnë një koncept të qartë për fenë dhe pastaj t'i përmbahen. Me ndihmën e Allahut mblodha atë që më kujtohej nga fjalët e dijetarëve eminentë të islamit, Allahu i mëshiroftë të gjithë, dhe kam përmendur burimet e disa prej fjalëve të tyre, kurse ndonjëherë i transmetoj në tërësi tekstet nga burimet e tyre ose disa pjesëza të lidhura me të tjerat, me qëllim që meselet e ndryshme dhe të shpërndara të fjalëve të ulemave të mund të ngjiten në një vend dhe e kam titulluar "*Inxhahu Haxhetis-Sa'il fi Ehemmil-Mesa'il*" ("*Kënaqja e nevojës së atij i cili pyet për çështjet më të rëndësishme*").

Prandaj them, duke e lutur Allahun që ta realizojë të dëshiruarën:

Këto janë bazat e fesë dhe çështje(mesele) të rëndësishme të lidhura për tewhidin dhe për atë që ndërlidhet dhe lidhet me të (tewhidin) nga dispozitat, të cilat i kam përpunuar në disa kapituj.

Kaptina e konstatimit të Tewhidit dhe sqarimit të llojeve të tij

1) Urtësia e krijimit të njerëzve dhe xhinnëve është bërja ibadet (adhurimi) vetëm Allahut dhe lënia e adhurimeve të dikujt tjetër përveç Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjësi?" (El-Kijame, 36)

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheni te Ne (për t'ju gjykuar)?" (El-Mu'minin, 115)

"Nuk i kam krijuar xhinnët dhe njerëzit për tjetër, pos që të Më adhurojnë." (Edh-Dharijat, 56)

Ibn Abbasi thotë:

"...vetëm që Mua të më bëjnë një".

Ai poashtu thotë se çdo urdhër për të bërë ibadet, në realitet urdhëron teuhidin.

Teuhidi, pra, është gjëja e parë që e ka për obligim ta mësojë secili *mukellef* (i detyruari *Sheriatik*) është obligimi (vaxhib) i parë dhe i fundit, e para me të cilën njeriu hyn në islam dhe e fundit me të cilën e lëshon këtë botë dhe për të do të jetë i pyetur në varr.¹

2. Ibadeti në kuptimin gjuhësor është marrur nga "përlshmëria". Thuhet "tarikun mu'abbed" që do të thotë rrugë e çelur, e ecur. E për sa i përket kuptimit sheriatik të fjalës ibadet, ai paraqet emër që përfshin gjithë atë që Allahu e do dhe me të cilën është i kënaqur prej fjalëve dhe veprave, si të jashtmeve ashtu edhe të zemrës, nga shkaku i fjalëve të të Lartësuarit:

¹ Shiko "*Tefsirul -Azizil - Hamid*" fq.29 dhe "*El-Intisar Lihizbilahil - Muvehhidin*" të shejhut të madh Abdullah Ebu Batin

"...të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne" (El-Bekare, 3)

3. Teuhidi është i ndërtuar mbi dy rukne – shtylla

- a) Maja e dashurisë
- b) Maja e përlulshmërisë dhe nënshtrimit ndaj të dashurit²

4. Sipas leximit të teksteve të shariatit dhe fjalëve të dijetarëve tewhidi mund të ndahet në tre lloje:

a) *Teuhidur-rububbije* – dmth Tewhidi (Njëshmëria e Allahut) në zotërim, i cili dmth të bërit Allahun Një në Veprat e Tija siç janë krijimi, pushteti, udhëheqja, furnizimi etj, për shkak të fjalëve të Të Lartësuarit:

"Thuaj: Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat? Ata do të thonë Allahu. E ti (o Muhamed) thuaj: Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?" (Junus, 31)

b) *Teuhidul-uluhijje* –Tewhidi (Njëshmëria e Allahut, i Vetmi pa shok) në hyjni, që do të thotë njësimi i Allahut me veprat e robërve siç janë namazi, kurhani, betimi, për shkak të fjalës së Të Lartësuarit:

"Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrhem Atij". (El-En'am, 162-163)

c) *Teuhidul-esma'i wes-sifat* - Teuhidi (Njëshmëria e Allahut) në emrat dhe cilësitë, që do të thotë (kërkon) ta përkrahim Allahun me atë që Ai e ka përkrahur Vetën në Librin e Tij ose me gjuhën e Pejgamberit të Tij, pa shtrembëruar kuptimin (*tahrif*), pa negacion (*ta'til*), pa e përcaktuar kualitetin (*tekjif*) dhe pa krahasim (*temthil*), për shkak të fjalëve të Tij:

"Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij. Ata do të ndëshkohen për çfarë kanë vepruar." (El-Ar'af, 180)

"Asgjë nuk është si Ai. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha." (Esh-Shura, 11)

"Atij i përket shembulli më i lartë në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (Er-Rum, 27)³

5. Teuhidin Rububije e kanë vërtetuar edhe Mushrikët, mirëpo kjo nuk i ka futur në Islam. Përkundrazi, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka luftuar kundër tyre, e ka bërë hallall gjakun, pasurinë dhe vendbanimet e tyre dhe i ka robëruar gratë e tyre për shkak të fjalëve të Të Lartësuarit:

"Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (mekasit paganë) se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën, me siguri që do të të thonë: Allahu." (Ez-Zumer, 38)

"Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim." (Jusuf, 106)

Ky lloj tewhidi edhe pse është i obliguar nuk është i mjaftueshëm për ta plotësuar obligimin.⁴

Si dhe nga shkak i fjalëve të Të Dërguarit të Allahut saws, të cilat i transmeton Ibn Umeri:

"Jam i urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa nuk dëshmojnë LA ILAHE IL-ALLAH dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ta falin namazin dhe ta japin zekatin, e kur t'a bëjnë këtë - e kanë të ruajtur nga unë jetën dhe pasurinë, përveç kur është në pyetje e drejta e Islamit, kurse llogarinë do t'a japin para Allahut."⁵

² Shiko "El-Ubudijje" të shejhul-islamit Ibn Tejmijje dhe "Mexhmugatu-Teuhid" 1/62-64

³ Shiko "Mexhmu'atut-Tewhid" 1/5

⁴ "Mexhmu'atut-Teuhid" 1/170, "Ed-Durerus-Senijje" 2/24, 10/97,98

⁵ Muttefekun alejhi

6. Nga këtu del se Tewhidi ka përparësi para cilëso çështje tjetër, sikur që janë namazi, zekati, haxhxi, agjërimi dhe dispozitat tjera islame, për shkak të fjalës së Allahut:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.” (El-Bejjine, 5)

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, 13 vite ka qëndruar në Mekke duke thirrur në Tewhid, përderisa namazi sipas një mendimi është bërë obligim në vitin e 10 H.

Kur e ka dërguar Muadhin në Jemen në vitin e 10 të Hixhretit, i ka thënë:

“Ti do të shkosh te një popull nga ithtarët e Librit, andaj gjëja e parë në të cilën do t’i thërrasësh le të jetë dëshmia se nuk katë adhuroar tjetër (me të drejtë) përveç Allahut...”

Në një transmetim tjetër qëndron se i ka thënë:

“...t’a realizojnë tewhidin në Allahun (ta njësojnë Allahun Një)...”

Kurse në një tjetër:

“...t’i bëjnë ibadet vetëm Allahut”

Dhe pas kësaj ka përmendur namazin, pastaj zeqatin e kështu me radhë⁶

7. Poashtu shirku dhe ndalesa e saj ka përparësi para çdo ndalesë tjetër, si martesës me nënën ose motrën, varrosjes për së gjalli të vajzave të posalindura, ngrënies së ngordhësirave, pirjes së pijeve dehëse. Allahu, subhanehu ve te’ala thotë:

“Thuaju: ‘Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)...’ ” (El-En’am, 151)

Pastaj ka përmendur ndalimin e vrasjes pa të drejtë dhe amoralitetet tjera, si ato publike ashtu edhe të fshehta.⁷

Kaptina e obligueshmërisë së Kufrit kundër Tagutit dhe sqarimi i kuptimit të tij

1. Urdhëri i Tewhidit e paraqet Dinin (fenë) e përgjithshëm rreth të cilit janë pajtuar Da’wet (thirrjet) e gjithë pejgamberëve, me llojllojshmërinë e shariateve, për shkak të fjalëve të Të Lartësuarit:

“Ne nuk kemi dërguar asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!’ ” (El-Enbija, 25)

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Ne pejgamberët jemi vëllezër, kemi një fe, kurse nënat i kemi të ndryshme”

Rreth ligjeve Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë.” (El-Ma’ide, 48)

Ky është kuptimi i fjalës “vëllezër” i përmendur në hadith.⁸

⁶ Të gjitha këto transmetime gjenden te “Sahihu” i Buhariut

⁷ “Ed-Durerus-Sennijje” 2/121,32,272

⁸ Them: Babain e kanë të njëjtë, d.m.th. Tewhidin, kurse Nënat të ndryshme, d.m.th. ligjet (sh.p.)

Pra, Tewhidi është ajo gjë e cila që nga lashtësia, pa edhe sot, ka qenë objekt debatesh dhe konfliktesh në mes Pejgamberëve dhe ithtarëve të tyre (nga njëra anë) dhe Tagutëve dhe mbrojtësve (shokëve) të tyre (nga ana tjetër).

I Lartmadhërishmi ka thënë:

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): Adhuroni Allahun dhe shmanguni Tagutit! Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje.” (En-Nahl, 36)⁹

2. Ibadeti ndaj Allahut nuk do të jetë i realizuar(plotësuar) përveç se me Kufër kundër Tagutit, për shkak të fjalëve të Allahut:

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.” (El-Bekare, 256)

Dhe për shkak të fjalëve të Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem:

“Kush e kryen teuhidullah...”

Kurse në rivajetin tjetër:

“Kush thotë LA ILAHE IL-ALLAH dhe bën Kufër në gjithë atë që adhurohet përveç Allahut – e ka të mbrojtur pasurinë dhe jetën, kurse llogarinë do ta jep para Allahut të Lartësuar.”¹⁰

Kjo është prej çështjeve që më së miri e sqaron kuptimin e fjalës LA ILAHE IL-ALLAH.

Këtu shohim se vetëm shqiptimi e Shehadetit nuk e mbron jetën(gjakun) dhe pasurinë, as njohja e kuptimit të tij dhe as vërtetimi i tij; bile as fakti se ai nuk i lutet askujt përveç Allahut Një i Cili nuk ka shok; gjegjësisht, nuk e mbron gjakun dhe pasurinë nëse kësaj nuk ia shton Kufirin në gjithë atë që adhurohet përveç Allahut. E nëse dyshon ose hamendet - nuk do ta ketë të mbrojtur as gjakun, as pasurinë.

Sa e bukur dhe sa e mrekullueshme është kjo mes’ele! Sa spjegim i mirë e sa dëshmi e qartë është kjo, për çdo kundërshtar.

3.Termi Tagut gjuhësisht është nxjerrur nga fjala “Tug-jan” që do të thotë kalim i kufirit. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur vërshoi uji i madh, Ne ju ngarkuam ju në anije” (El-Hakka, 11)

Kuptimi i saj në Sheriat është: tërë ajo në të cilën robi e kalon kufirin e tij prej të adhuruarve, të pasuarve ose atyre që iu nënshtrohet.

“Tagut është çdokush para të cilit gjykohet(nga i cili kërkohet gjykim) përveç Allahut dhe Pejgamberit saws ose të cilin e adhurojnë përveç Allahut, ose të cilin e pasojnë pa argument(të shpallur) nga Allahut, ose i nënshtrohen në atë që nuk e dijnë se ai nënshttrim i takon vetëm Allahut. Këto janë Tagutat e botës për të cilët, nëse mendon rreth tyre dhe nëse mendon për gjendjen e njerëzve sot do të vëresh se si shumica e tyre janë kthyer prej ibadetit ndaj Allahut në ibadetin ndaj tyre dhe prej nënshttrimitt ndaj Tij dhe pasimit të pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, në nënshttrimin ndaj tagutave dhe pasimin e tyre”¹¹

4. Kualiteti i bërjes kufr në tagut bëhet me pesë gjëra që i ka përmbledhur imami dhe reformatori Muhammed bin AbdulWehhabi, rahimehullahu te’ala, kurse ato janë:

1. Bindje e forte në pavërtetësinë (parregullsinë) e bërjes Ibadet cilitdo tjetër përveç Allahut
2. Lënia (braktisja) e tij

⁹ Shiko meselet e kaptinës së parë të “Kitabut-Tewhid”

¹⁰ Transmetojnë Ahmedi dhe Muslimi, kurse baza është te Ahmedi

¹¹ Ky është definicioni i Ibn Kajjimit në “Itamul-muvekkigin”, për të cilën dijetarët e teuhidit thonë se ky është definicioni më i mirë për tagutin

3. Urrejtja ndaj tij
4. Tekfir ndaj Tagutave dhe i atyre që i adhurojnë
5. Armiqësi ndaj tyre për hir të Allahut (dmth. kundërshtimi i tyre).

Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: gNe distancohemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm. ” (El-Mumtehine, 4)

Pra, secili që nuk realizon përshkrimin që e përfshin kualitetin e bërjes Kufër në Tagut, nuk bëhet besimtar në Allahun dhe Kafir në Tagut.¹² Përkundrazi, do të jetë e kundërta, sepse imani në Tagut dhe imani në Allah janë dy sende të kundërta të cilat asnjëherë nuk mund të bashkohen në zemrën e njeriut, sepse nuk është e mundur që i njëjti njeri të jetë Mushrik dhe Muwehhid në të njëjtën kohë.

Përkundrazi, njeriu patjetër e meriton njërin prej këtyre dy përshkrimeve, kurse i treti nuk ekziston, për shkak të fjalëve të Allahut:

“Është Ai që ju krijoi juve, e megjithatë, disa prej jush janë mohues e disa besimtarë.” (Et-Tegabun, 2)

Dhe për shkak të fjalëve:

“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.” (El-Insan, 3)¹³

Ky pra, është ai Tagut në të cilin jemi urdhëruar të bëjmë Kufër dhe t'i largohemi dhe ky është Ibadeti që e kemi të ndaluar t'ia bëjmë dhe të cilin jemi urdhëruar ta lëmë, e poashtu edhe ata që e bëjnë këtë, dhe t'i kundërshtojmë.¹⁴

Kaptina për sqarimin e thelbit të Islamit dhe Shirkut dhe dallimeve mes tyre

1) Burimi te i cili kthehemi kur kemi të bëjmë me emrat e Sheriatit, sikur që janë *musliman, mushrik, kafir, risimtar ose fasik*, është ai që e ka përkufizuar Ligjdhënësi, edhe në esencë edhe në kuptim. Ai që nuk e dallon thelbin e këtyre emërtimeve dhe nuk ka pasqyrë reale për to - do të has në gabime dhe përzjerje të nocioneve. Allahu i Lartësuar i ka qortuar ata të cilët nuk i dinjë kufijtë e asaj që Allahu ia ka shpallur të Dërguarit të Tij, duke thënë:

“Beduinët janë mohuesit dhe hipokritët më të mëdhenj dhe më të prirët për të mos njohur kufijtë, që Allahu ia ka shpallur të Dërguarit të Tij.” (Et-Teube, 97)¹⁵

2) Allahu i Lartësuar në Librin e Tij dhe me gjuhën e të Dërguarit të Tij e ka sqaruar thelbin e Islamit dhe Shirkut dhe të gjitha dispozitat e dunjasë dhe ahiretit që lidhen me to.

Islami është – dorëzim(besnikëri) vetëm Allahut të Lartësuar me Tewhid dhe nënshtrim Atij me përulësi dhe braktisje(largim) nga Shirku dhe vepruesit e tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

¹² Them: Nuk janë të gjitha gjërat që paraqesin Kufirin në Tagut në të njëjtën shkallë. Pa disa prej tyre kjo tërësi asesi nuk ekziston, që do të thotë se janë rukn (shtyllë) të kësaj tërësie, ndërsa ka edhe disa të cilat formojnë obligim të plotësimi të kufirit në tagut, të cilat nëse njeriu i lë - ndonjëherë bëhet fasik (mëkatar), ndonjëherë kafir dhe ndonjëherë nuk ka mëkat, varësisht nga dija e tij për çështjen në fjalë. Prandaj nuk është prej parakushteve të hyrjes në Islam që njeriu menjëherë në fillim të dijë, besojë dhe bëjë tekfir ndaj veprave të caktuara dhe vepruesit e tyre, sepse mund të jetë i paditur për atë çështje, por që të jetë musliman duhet patjetër të dijë, të besojë dhe t'i ruajë me vepra, që asnjëra prej llojeve të ibadetit të mos i jetë drejtuar dikujt tjetër përveç Allahut dhe që i tërë ibadeti duhet t'i drejtohet vetëm Allahut (sh.p.)

¹³ Shiko “*Mexhmu’atul-Tewhid*” 1/8 dhe “*Ed-Durerus-Senijje*” 2/359-360

¹⁴ Shiko “*Mexhmu’atul-Tewhid*” 1/12,17

¹⁵ Shiko “*Mexhmu’atul-Fetava*” 19/335, “*Minhexhut-Tes’is vet-Takdis*” të shejhut të madh Abdul-Latif Ali shejh, fq.12 dhe “*El-Intisar...*” të shejhut të madh Abdullah Ebu Batin, fq.20

“Vërtet, ata që i përuan Allahut dhe bëjnë vepra të mira...” (El-Bekare, 112)

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Islami është ta adhurosh Allahun dhe asgjë mos t’i bësh shok dhe ta falish namazin.”

Dhe e ka definuar si dorëzim ndaj Allahut me Tewhid e braktisje të Shirkut, si e para, dhe vendosjen e dispozitave të jashtme që e tregojnë nënshtrimin.

Shirku është - barazimi i krijesës me Krijuesin, dhe të drejtuarit e çfarëdo lloj ibadeti atij. I Lartësuarit, kur flet për atë se mushrikët pranojnë gabimet e veta, thotë:

“Betohemi për Allahun, ne kemi qenë njëmend në humbje të qartë, kur ju kemi barazuar me Zotin e botëve.” (Esh-Shu’ara, 97-98)

“Prandaj mos sajoni me vetëdije zota (endad)¹⁶ të barabartë me Allahun.” (El-Bekare, 22)

Në Hadith thuhet:

“...Allahut t’i bësh ‘Nidda’, kurse Ai të ka krijuar.”

Kuptimi gjuhësor poashtu e sqaron domethënien e shirkut në Sheriat. Shirku në gjuhë është marrë nga “mushareke” mes dy vetave që d.t.th. “pjesëmarrje” e dy (apo më shumë vetave) në një send.

I Lartësuarit ka thënë:

“Dëgjojeni këtë shembull që ka sjellë Allahu! Janë dy njerëz: njëri ka shumë bashkëpronarë që e kundërshtojnë njëri-tjetrin, ndërsa tjetri ka vetëm një pronar, të cilit i përkushtohet. A janë të njëjtë ata në krahasim?! Lavdëruar qoftë Allahu, por shumica e tyre nuk e dinë këtë!” (Ez-Zumer, 29)

I pari është objekt i pjesëmarrjes, kurse të dytin e ka përmendur të pastërt, pa “ortakllëk” (dmth. bashkëpjesëmarrje dhe bashkëveprim).

3) Shirku i madh nuk falet, përveç se me Tewbe para se personin t’a zë vdekja, kurse Allahu do t’ia fal atij që do, çka është më e vogël se Shirku. Ka thënë i Lartësuarit:

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.” (En-Nisa,116)

Në hadith thuhet:

“Allahu nuk pranon asnjë vepër prej njeriut, që pas Islamit të tij, bën Shirk...”¹⁷

4) Kushdo që vdes në Shirk të madh – do ta ketë të ndaluar hyrjen në Xhennet dhe e meriton zjarrin përgjithmonë, për shkak të fjalëve të të Lartësuarit:

“Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhennetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës.” (El-Magide, 72)

Dhe për shkak të fjalëve të të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

“Kush vdes duke e lutur dikë tjetër përveç Allahun – do të hyjë në zjarr.”

Në Hadithin tjetër qëndron:

¹⁶ “Endad” është shumësi i fjalës “nidd” që do të thotë i ngjashëm, i njëjtë, etj. (sh.p.)

¹⁷ Shiko “Sahihun” e Ibn Hibbanit 1/376

*"Kush e takon Allahun duke mos i bërë Shirk në(me) asgjë - do të hyjë në Xhennet, dhe kush e takon duke i bërë shirk në çfarëdo mënyre - do të hyjë në zjarr."*¹⁸

Hyrja e mushrikut në zjarr është e karakterit të përgjithshëm; d.m.th., çdonjëri (secili) mushrik do të hyjë në të dhe aty do të mbetet përgjithmonë. Aty nuk ka dallim mes Çifutëve, adhuruesve të idhujve, zjarrit apo kryqit, atyre që kundërshtojnë fenë islame ose i përshkruhen atij, as atij që e kundërshton (me inat) të vërtetën¹⁹ ose nuk e njeh (të vërtetën)²⁰ prej njerëzve dhe xhinëve.²¹

Kaptina e (rreth) sqarimit të kuptimit të el-Wela dhe el-Bera, rreth obligimit të shprehjes (së jashtme) të fesë dhe arsytimit të të shtypurve

1. Dije se Islami i njeriut nuk do të jetë në rregull, edhe nëse vjen me Tewhid dhe i larguar nga shirku, nëse nuk e ka armiqësinë ndaj mushrikëve dhe distancimin e qartë prej tyre, për shkak të fjalëve të të Lartësuarit:

"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre." (El-Muxhadele, 22)

Në hadith qëndron:

*"Lidhja më e fortë e imanit është dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut"*²²

El-'alame Hamed bin 'Atik thotë:

"Sa i përket armiqësisë ndaj kafirave dhe mushrikëve, dije se Allahu i Lartësuar e ka bërë obligim dhe këtë obligim e ka vërtetuar dhe dije se e ka ndaluar miqësimin me ta dhe këtë çështje e ka theksuar me 'theks' të madh, ashtu që në Libin e Allahut të Lartësuar, pas obligimit të Tewhidit dhe ndalimit të së kundërtës së saj (Shirkut) – pothuajse nuk ka asnjë dispozitë tjetër me aq argumente të shumta dhe të qarta se sa kjo dispozitë."

Pra, është e patjetërsueshme të realizohet el-Wela dhe el-Bera.

2. Baza e (patjetërsueshme)²³ e el-Bera është urrejtja, kurse baza e (patjetërsueshme) e el-Wela është dashuria, për shkak të fjalëve të të Lartësuarit rreth fjalëve të Ibrahimit, alejhis-selam, drejtuar popullit të tij:

"Ai tha: A keni menduar mirë mbi çfarë keni adhuruar, si ju, ashtu edhe të parët tuaj të lashtë? Në të vërtetë, ata janë armiqtë e mi, përveç Zotit të botëve. " (Esh-Shu'ara, 75-77)

Duke pasur parasysh që baza e el-Bera është urrejtja, vendi i së cilës është në zemër, dega e saj e jashtme është armiqësia. I Lartësuarit ka thënë:

"Shembulli i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuronin në vend të Allahut ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm." (El-Mumtehine, 4)

¹⁸ E shënon Muslimi

¹⁹ Them: është 'inatçor', nga fjala 'inat', kurse i këtillë bëhet pas njohjes (qartësisë) të gjërave. Kuri inada është njëri nga llojet e Kufrit, por jo i vetmi (sh.p)

²⁰ Injoranca e përmendur këtu është injoranca e *i'radit*, dmth e *kthimit (rrotullimit)*, refuzimit dhe lënies pas dore, atë që *mukellefi* ka mundur ta largojë, por nuk i ka interesuar. Për këtë arsye ai e ka dispozitën e njëjtë (në meritimin e dënimit) sikur ai që di. *Kufrul-i'radi* poashtu paraqet një rëndësi prej llojeve të kufrit dhe sot ai është lloji më i shpeshtë i kufrit. Prandaj, le të kenë kujdes të paditurit dhe ata që i arsyetojnë pa dituri (sh.p.)

²¹ Shiko "*Fethul-Mexhid*", Kaptinën e frikës nga shirku

²² "*Ed-Durerus-Senijje*" 8b435, 10b139-140, "*Sebilun-NexhatI vel-Fikak min Muvalatil-Murteedine ve Ehlil-Ishrak*"

Transmeton imam Ahmedi nga Bera'a ibn Azibi, ndërsa hadithi është, duke e pasur parasysh shumësinë e rrugëve të tij, hasen. Këtë e thotë el-Albani, rahimehullah.

²³ Fjala "e patjetërsueshme" është shtesë e përkthyesit Boshnjak. Për këtë shkak është në kllapa (sh.p.)

Dhe kjo, sikur që kemi përmendur më herët, bie në përshkrimin e kufrit në Tagut.

"Këtu në lidhje me fjalët e të Lartësuarit:

"Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut..."

- ka porosi të madhe dhe dobi. Pra, Allahu i Lartësuar ka përmendur distancimin prej mushrikëve, adhuruesve të dikujt tjetër përveç Allahut, para distancimit nga idhujt që adhurohen përveç Allahut, sepse e para është më e rëndësishme se e dyta. Ngase, është e mundur që personi të largohet (distancohet) nga idhujt, por mos të largohet (distancohet) nga ata që i adhurojnë idujt dhe kështu të mos e realizojë atë me të cilën është urdhëruar. Mirëpo, kur të largohet (distancohet) nga mushrikët – kjo me vete domosdo e tërheq distancimin nga zotat e tyre. Kuptoje mirë këtë vërejtje, sepse ajo do të t'i hap dyert e armiqësisë ndaj armiqve të Allahut. Sa njerëz ka që nuk i bëjnë shirk, por nuk i armiqësojnë mushrikët dhe si të tillë edhe nuk janë muslimanë, sepse e kanë lënë fenë e të gjithë peygamberëve. Pastaj vijmë fjalët e të Lartësuarit:

"Ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm." (El-Mumtehine 4). *Fjalët e Tij (Allahut):*

"...haptas do të jetë..." dmth. nga ana e jashtme dhe qartë. Kushtoj vëmendje asaj se armiqësia është përmendur para urrejtjes, për arsye se e para është më e rëndësishme se e dyta. Ngaqë njeriu ndoshta mund t'i urrejë mushrikët, por nuk i kundërshton, dhe kështu nuk e ka realizuar 'waxhibin' (obligimin) përderisa nuk e realizon armiqësinë dhe urrejtjen, edhe pse urrejtja është e lidhur me zemrën, sepse ajo nuk bën dobi derisa nuk vërehen gjurmët e saja dhe derisa shenja e saj të mos bëhet e qartë. Kurse ajo nuk bëhet e atillë derisa nuk bashkangjitet me armiqësinë dhe bojkotin."²⁴

"Nuk llogaritet se një Musliman e ka shprehur (haptas) fenë e tij derisa nuk e kundërshton çdo grupacion në ato veprime (shenja) me të cilat ato (grupe) identifikohen dhe përderisa nuk ua tregojnë qartë armiqësinë dhe distancimin nga vepra e tyre. Para atyre (njerëzve), Kufri i të cilëve bëhet me Shirk – shprehja e fesë bëhet me paraqitjen e qartë të Tewhidit, ndalimin e Shirkut dhe tërheqja e vërejtjes për të (për Shirkun). Ai që e bën Kufirin duke i miqësuar Mushrikët dhe duke iu nënshtruar atyre – plotësimi i fesë para këtij bëhet duke shprehur armiqësinë ndaj tij dhe distancimin edhe nga ai edhe nga Mushrikët."²⁵

"Ndonjëherë muslimani ndoshta nuk është në gjendje ta shprehë armiqësinë ndaj kafirave dhe mushrikëve për arsye të ndonjë pengese ose arsyetimi, siç është shtypja, në rastin e atij që nuk ka force (mbrojtje) ose për shkak të detyrimit kur njeriu arsyetohet²⁶ deri në largimin e pengesës. Sa i përket atij që nuk e shpreh armiqësinë ndaj mushrikëve për shkak të ndonjë qëllimi të kësaj dunjaje ose për shkak të dhënies përparësi dobive (interesave) të kësaj bote, me urrejtjen ndaj tyre dhe bindjes se janë kafira – ai person është 'asija' (i padëgjueshëm) dhe mëkatar. Çdo njeri ka dispozitë për gjendjen e vet. Nëse mungon (humb) urrejtja në zemër me të humb edhe Imani për shkak të lidhshmërisë së jashtësisë dhe zemrës, sepse vendi i saj është zemra dhe askush nuk ka mundësi që me dhunë ose me diçka tjetër t'a largon urrejtjen prej zemrës, sikur që qartë shihet kjo nga fjalët e të Lartësuarit:

"...përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim...." (En-Nahl, 106)

Prandaj, kushtoi rëndësi (vëmendje) (mendo).²⁷

Kaptina rreth kuptimit të fjalës La ilahe il-Allah dhe sqarimi i kushteve (sharteve) të saj

1) Fjalja e Ihlasis "LA ILAHE IL-LALLAH" qëndron mbi dy rukne: ruknin e mohimit dhe ruknin e pohimit.

"LA ILAHE" mohon çdo hyjni (zot) të rrejshëm, kurse "IL-LALLAH" vërteton hyjninë e vërtetë vetëm të Allahut, subhanehu re te'ala. Nga kjo vjen edhe kuptimi: *"Nuk ka dikë që e meriton adhurimin, përveç Allahut".*

²⁴ Këto janë fjalët Shejhut Hamed bin 'Atik, rahimehullah. Shiko "Mexhmu'atut-Teuhid" 1/334-335

²⁵ Fjalët e dijetarit të madh Hamed bin 'Atik, rahimehullah. "Sebilun-NexhatI vel-Fikak..." nga "Mexhmugatut-Teuhid" 1b336-367, "Idahul-Mehaxhheti ves-Sebil" fq. 36 të shejh Is'hak ibn Abdir-Rahman

²⁶ I arsyetuar për gjërat që nuk mund t'i shprehë (sh.p)

²⁷ "Ed-Durerus-Senijje" 2/8, 305, 359, "Tekfirul-Muajjen" të dijetarit Ishak ibn Abdir-Rahman Ali shejh, fq.21

El-Halili në lidhje me të është shprehur me mohimin dhe pohimin, për të cilën në flet Allahu:

“Në të vërtetë, Unë i urrej dhe skam të bëj fare me ato që adhuron ju në vend të Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë. Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen (vazhdimisht tek Allahu).” (Ez-Zuhruf, 26-28)

Sipas ixhmasë së komentatorëve (mufessirinëve) me fjalën e përmendur në ajet mendohet në “LA ILAHE IL-ALLAH”.

2. Është e ndërtuar mbi dy shtylla:

a) *Sidku / çiltërsia* (vërtetësia, sinqeriteti)

b) *Ihlasi* / adhurimi i pastërt i Allahut

Me Sinqeritet realizohet pastrimi nga nifaku, kurse me Ihlas realizohet distancimi dhe pastrimi nga Shirku. Ibn Kajjimi në “*Nunijjen*” e tij thotë:

“Sidku dhe ihlasi janë dy shtylla të atij Tewhidi, sikur ndërtesa dhe dy muret e saj (më të rëndësishëm).”²⁸

3) Sipas ixhmasë së dijetarëve, kjo fjalë madhështore nuk i bën dobi atij që e shpreh, pa prezencën dhe realizimin e shtatë kushteve.

Këtu nuk është për qëllim vetëm numërimi i tyre dhe mësimi i tyre përmendësh, sepse sa është numri i Muslimanëve të zakonshëm te të cilët këto kushte janë takuar dhe të cilët iu përmbahen, por kur kërkohet prej tyre t’i numërojnë – ata nuk dijnë? Dhe sa janë ata që i dijnë përmendësh; i nxjerrin nga vetja sikur shigjeta, por i sheh se si rrasen në atë që i mohon ato.

Dijetari i madh, Sulejman bin Abdullah Ali Shejh ka thënë:

“Shqiptimi i fjalës LA ILAHE IL-LALLAH pa e ditur (njohur) kuptimin e saj dhe pa punuar (vepruar) sipas asaj që ajo kërkon – nuk bën dobi sipas ixhmasë.”²⁹

a) Kushti i parë është *eI-Ilm* (dituria), nga fjalët e Allahut:

“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut!” (Muhammed, 19)

Dhe nga fjalët e të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

“Kush vdes duke e ditur se s’ka zot përveç Allahut do të hyn në xhennet.”³⁰

b) *EI-Jekin* (bindje e fortë), që e eliminon dyshimin, për shkak të fjalëve të Allahut:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të singertë.” (EI-Huxhurat, 15)

Dhe nga fjalët e të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

“Këdo që e takon pas këtij muri (kopshti) duke dëshmuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, duke qenë fuqishëm i bindur në të, përgëzoje me xhennet...”

Kurse në rivajetin:

“Nuk do të ketë rob me ta që e takon Allahun, duke mos dyshuar në ta – e që të mos hyjë në Xhennet”³¹

²⁸ Shiko “*Mexhmu’atut-Tewhid*” 1/168

²⁹ “*Tefsirul-‘Azizil-Hamid fi Sherhi Kitabit-Tewhid*” fq. 64-70

³⁰ Transmeton Muslimi nga Othman ibn Affani, radijallahu anhu

c) *El-ihlas* (adhurimi i pastër i Allahut) që e eliminon shirkun, për shkak të fjalëve të Allahut:

“Andaj, adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!” (Ez-Zumer, 2)

“...që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre” (El-Mu'minun, 59)
Dhe nga fjalët e të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

“Kush thotë LA ILAHE IL-LALLAH halis(pastër) nga zemra e tij...”

Kurse në rivajetin: “... muhlisan (plotësim i Ihlasit)...”³²

Dhe nga hadithi:

“Kush e takon Allahun duke mos i bërë Shirk në asgjë – do të hyn në Xhennet dhe kush e takon duke i bërë Shirk në çfarëdo mënyre – do të hyjë në Zjarr.”³³

d) *Es-Sidk* (sinqeritet) që e eliminon gënjeshtren (rrenën), për shkak të fjalëve të Allahut:

“Kur vijnë tek ti hipokritët, thonë: ‘Ne dëshmojmë se ti je vërtet i dërguari i Allahut!’ Allahu e di se ti je i dërguari i Tij, por Ai dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë!” (El-Munafikun, 1)

Në hadith qëndron:

“Askush nuk do të dëshmojë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, sinqerisht nga zemra e tij, e që Allahu mos t’ia bën të ndaluar hyrjen në zjarr.”³⁴

e) *El-Kabul* (pranimi), që e eliminon *redd* (refuzimin), për shkak të fjalëve të Allahut:

“Thuani: ‘Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve...’ ” (El-Bekare, 136)

Dhe për shkak të hadithit:

“Nuk do të hyjë në xhennet askushi, në zemrën e të cilit ka një grimcë kryelartësie”³⁵

f) *El-Inkijad* (nënshtrim), që e eliminon lënien, për shkak të fjalëve të Allahut:

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” (El-Hashr, 7)

Dhe për shkak të fjalëve të të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

“Kur t’u ndaloj diçka - largohuni prej saj, kurse kur t’u urdhëroj diçka - kryeni sa të keni mundësi.”³⁶

g) *El-Mehhabe* (dashuria), që e eliminon të kundërtën e saj prej urrejtjes dhe mosdurimit për shkak të fjalëve të Allahut:

“Thuaju (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë...” (Ali Imran, 31)

Kurse në hadith qëndron:

“Hallka (Lidhja) më e fortë e imanit është urrejtja në emër të Allahut dhe dashuria në emër të Allahut.”

³¹ Hadithi transmetohet nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu

³² Shënon Buhariu

³³ Shënon Muslimi nga Xhabiri r.a

³⁴ Shënon Buhari dhe Muslimi nga Enesi r.a

³⁵ Shënon Muslimi

³⁶ Transmeton Buhari nga Ebu Hurejre r.a

4) Me këtë qartë theksohet mendimi i ehli-sunnetit dhe xhema'atit rreth çështjes së imanit - se imani është shqiptim me gjuhë, bindje me zemët dhe veprim sipas dispozitave/rukneve. Dhe nëse mungon (bile) njëra nga këto trija, atëherë personi e humb imanin, për shkak të fjalëve të Allahut:

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: Unë, me të vërtetë jam musliman." (Fussilet, 33)³⁷

Kaptina rreth gjërave që e mohojnë Islamin (e nxjerrin personin nga Islami) dhe Kufrit të atij që e vepron njëren prej tyre, përveç nëse ka qenë i detyruar(dhunuar)

1) Çdo njeri e ka për obligim t'i njeh dhe t'i njohë dhe mësojë anuluesit e Islamit, apo gjërat që e prishin, që të mund t'u ikë e larguar.

Ka thënë shejh Muhammed ibn AbdulWehhabi:

"Dije se ekzistojnë dhjetë vepra(çështje) që e prishin islamin:

1. Shirku në adhurim Allahut (të bërit shok, ortak gjatë adhurimit). I Lartësuar ka thënë:

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë." (En-Nisa, 116)

"Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës." (El-Ma'ide,72)

Këtu bën pjesë kurban i dikujt tjetër përveç Allahut, siç është therrja/kurbani për Xhinnët dhe varret.

2. Kush merr ndërmjetësues mes tij dhe Allahut, të cilëve u lutet, nga të cilët kërkon shefa'at dhe te të cilët mbështetet. Ky është pabesimtar me ixhma(pajtimin e të gjithë dijetarëve).

3. Kush nuk i bën tekfir Mushrikët, dyshon në kufirin e tyre ose e konsideron të drejtë(vërtetë) rrugën e tyre.

4. Kush beson se udhëzimi i dikujt tjetër krahas udhëzimit të pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, është më i kompletuar, ose se gjykimi(ligji) i dikujt tjetër është më i mirë se gjykimi(ligji) i tij, sikur ata që i japin përparësi gjykimit të Tagutit para gjykimit të pejgamberit, salallahu alejhi ve selem. Personi i këtillë është kafir.

5. Kush urren diç prej asaj me të cilën ka ardhur i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem. Ky është kafir edhe nëse e vepron atë që e urren.

6. Kush tallet me diçka prej fesë së të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, ose me shpërblimin dhe dënimin është kafir. Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

"Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim. Thuaj: A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni? Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar." (Et-Tewbe, 65-66)

7. Sihri, e prej tij është 'sarfi' dhe 'atfi'. Kushdo që e bën atë ose është i kënaqur me të bëhet kafir. Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

"Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: Ne jemi dërguar për t'ju vënë në provë, andaj ti mos u bë mohues..." (El-Bekare, 102)

8. Përkrahja dhe të ndihmuarit e mushrikëve kundët muslimanëve. Argument për këtë janë fjalët e të Lartësuarit:

³⁷ Shiko "Mexhmu'atut-Tewhid" 1/131, "Ed-Durerus-Senijje" 2/35

"Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit." (El-Ma'ide,51)

9. Kush beson se disa njerëzve u lejohet dalja nga Sheriati i Muhammedit, salallahu alejhi ve selem, ashtu siç e ka pasur të lejuar Hidri të del nga Sheriati i Musaut, alejhis-selam, është kafir.

10. Largimi(kthimi) nga feja e Allahut, mosmësimi i saj dhe as të vepruarit me të. Argument për këtë janë fjalët e të Lartësuarit:

"Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj keqbërësve!" (Es-Sexhde, 22)

Në këto negacione nuk ka dallim mes atij që tallet, atij që është serioz dhe atij që frikësohet, përveç të dhunuarit. Çdonjëra prej këtyre çështjeve bie në ato më të rrezikshmet dhe në ato që më së shpeshti ndodhin, prandaj muslimani e ka obligim të ruhet(ketë kujdes prej tyre) dhe të frikësohet mos të bie në to. I mbështetemi Allahut nga shkaqet e Hidhërimit të Tij dhe dënimit të Tij të dhimbshëm.³⁸

2) Krejt ajo që u përmend në tekstin e mësipërm ia hap atij të drejtit njohurinë për rëndësinë e mësimit të kapitullit mbi gjykimin e murtedit dhe nevojën për të, të cilën gjë e përmendin juristët e secilit medhheb, kur thonë:

"Murtedd është çdonjëri që bën mosbesim pas islamit, nëpërmjet fjalëve, ose veprave, ose bindjes, ose dyshimit, ose xhehlit, ose me te'wil..."

Për atë arsye thuhet:

"...kërkohet prej tij të pendohet..."

- që t'i thuhet se e ka anuluar Islamin e vet dhe e ka bërë atë që është shkak për daljen dhe mosbesimin e tij. Nëse pendohet – do të lihet i lirë, e nëse jo – atëherë mbytet/vritet. Dhe nuk e kanë përjashtuar askënd tjetër përveç atij që dhunohet, me kusht që zemrën t'a ketë të qetë me iman. Këtë e kuptojmë nga fjalët e Allahut:

"...përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim." (En-Nahl,106)³⁹

Krejt kjo realizohet në fjalët e Të Lartmadhëruarit:

"Thuaj: Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I lavdëruar qoftë Allahu unë nuk jam prej idhujtarëve!" (Jusuf, 108)

Këtu qartë shihet(vërehet) se sa është e vlefshme dituria dhe dijetarët. Dhe mendo, o ti i cili e don fjalën e Allahut, rreth fjalëve të Tij drejtuar Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, pas 20 viteve të pejgamberisë:

"Dije se nuk ka të adhuruar tjetër (me të drejtë) përveç Allahut!" (Muhammed 19)

3) Pas sqarimit të nocionit 'ibadet' dhe llojeve të tij, Tewhidit dhe llojeve të tij, Tagutit dhe shembujt e tij dhe obligueshmërisë së braktisjes së tij, dije se kush ia drejton ndonjë ibadet dikujt tjetër pos Allahut – ai ka besuar në tagut dhe ka mohuar(ka bërë kufr) në Allahun, edhe nëse pohon se është musliman dhe i kryen obligimet (ruknet). Kjo është kështu, për shkak se pranimi i veprave varet nga kushti i rregullsisë së tyre, e kjo është Tewhidi. Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

"Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen" (El-Ma'ide, 5)

"Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit." (Ez-Zumer, 65)

³⁸ "Mexhmu'atut-Tewhid" 1/38-39, "Ed-Durerus-Senijje" 2/360

³⁹ Shiko "El-Intisar..." të shejh Abdullah Ebu Batinit, "Mexhmu'atut-Tewhid" 1/107,114, "Ed-Durerus-senijje" 10/88

“Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe.” (Ibrahim, 18)

Krejt ky kërcënim (ajetet e mësipërme) nga shkakut se nuk e ka mësuar (kuptuar) domethënien e La Ilahë Illallah, nuk e ka realizuar Islamin, përveç të cilit Allahu nuk pranon fe tjetër. Ka thënë i Lartësuari:

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.” (Ali Imran, 85)

Pas kësaj, çdokujt që i është hapur gjoksi dhe ka kuptuar palcën e Teuhidit dhe Imanit i bëhet e qartë madhësia e gurbetllëkut i kësaj feje dhe thelbi i davetit (thirrjes) të të gjithë pejgamberëve, dhe mileti i babait tonë, Ibrahimit, alejhis-selam, të cilin jemi të urdhëruar ta pasojmë duke u bazuar te fjalët e Allahut:

“Pastaj ty të shpallëm: Paso me sinqeritet fenë e Ibrahimit, që nuk ka qenë prej idhujtarëve.” (En-Nahl, 123)⁴⁰

Kapitulli për detyrueshmërinë e dallimit në mes Meseleve (çështjeve) të njohura dhe atyre më pak të njohura

1) Sa i përket atij që e mohon ndonjë Waxhib ose e lejon ndonjë haram dhe i njëjti nuk i di “dispozitat përkatëse”, sikur që është muslimani i ri ose ai që ka jetuar larg në shkretëtirë - ai arsyetohet me paditurinë e tij dhe nuk gjykohej për kufër, por duhet t’i sqarohet, e nëse kundërshton pasiqë t’i paraqiten argumentet – atëherë bëhet murtedd (renegat). Ndërsa, sa i përket atij që ka jetuar (është rritur) në mesin e muslimanëve, në qytetet dhe fshatrat e muslimanëve, ai person nuk arsyetohet, e as që pranohet prej tij, sipas Ixhma (pajtimin e gjithë dijetarëve), thënia “padituri”, sepse dispozitat nuk bëhen detyruese përveç pas “ardhjes”.

Kurse argumenti, për sa u përket dispozitave, realizohet (plotësohet) me:

- a) Mundësinë e nxënies së diturisë dhe
- b) Aftësinë e kryerjes së veprave⁴¹

2) Sa i përket mosdijes së disa prej Emrave dhe Cilësive të Allahut: ai që është i paditur në lidhje me to – nuk është Kafir, nëse vërteton atë me të cilën ka ardhur i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, dhe nëse deri te ai nuk ka ardhur ajo (argumenti) që e detyron t’a dijë (t’a mësojë) atë që nuk e di, në mënyrën e cila me vete e tërheq Kufrin në rast paditurie, sikur njeriu që e ka urdhëruar familjen e tij ta djegin. Por, për atë person thuhet se është “kryes i mëkatit” ose “gabimtar”, dhe se mbi të nuk është ngritur argumenti. Dhe thuhet: “Kush e thotë këtë dhe këtë - është kafir”, dhe tekfiri shprehet në përgjithësi, kurse sa i përket tekfirit konkret, ai varet nga plotësimi i kushteve dhe largimit të pengesave në raste të personave konkret.

Pra, është patjetër që, me rastin e sjelljes së gjykimit ndaj të “paditurit” është e patjetërsueshme të bëhet dallim mes çështjeve të “njohura” dhe “më pak të njohura”, çështjeve precize (të holla) argumeti i të cilave mund të jetë i panjohur (fshehur) për disa njerëz.

Për këtë, shejhul-islami thotë:

“Nëse kemi të bëjmë me çështje më pak të njohura, mund të thuhet se është “kryes i gabimit” ose “gabimtar”, nuk është ngritur argumenti - që të mund kryesi të bëhet pabesimtar. Mirëpo te disa grupacione të tyre ndodh në çështjet e njohura, për të cilat dinë edhe Muslimanët e zakonshëm edhe ata të ditur. Bile edhe jehudët, të krishterët dhe mushrikët e dinë se Muhammedi a.s. është dërguar me to dhe se e ka bërë tekfir atë që e ka kundërshtuar, siç është urdhëri i tij për t’i bërë ibadet vetëm Allahut, të Vetmit, i Cili nuk ka shok dhe ndalesa e bërjes ibadet dikujt tjetër përveç Allahut, qofshin ato melekë, pejgamberë ose diçka tjetër. Këto çështje bëjnë pjesë në çështjet më të njohura të Islamit ose sikur

⁴⁰ Shiko “Ed-Durerus-Senijje” 11/6, 545, “Ed-Durerus-Senijje” 2/350, “Mexhmu’atul-Tewhid” 170,171

⁴¹ Shiko “Et-Tefsir fi Me’alimid-Din” të Ibn Xheririt, fq.112,113, “El-Intisar” të Ebu Batinit, fq.11,18, “El-Mugni” të Ibn Kudames 3/351, “Ed-Durerus-Senijje” 10/371, 370, 355, 372, 432, 423, “Mexhmu’atul-Fetava” (28/50), (12/94,20), (4/259,252), (18/54) dhe (2/54).

armiçësia ndaj jehudëve, krishterëve dhe mushrikëve, si ndalesa e amoralitetit, kamatës, verës, bixhozit dhe të ngjashme me to. Përkundër kësaj do të gjesh shumë nga udhëheqësit e tyre se si kanë rënë në këto lloje, dhe janë bërë murtedda, edhe nëse ndokush do të pendohej dhe do t'i kthehej (të vërtetës).⁴²

Kaptina e pengesave dhe kushteve për tekfir të pasuesve të epshit dhe risive

Kushtet e tekfirit të pausesve të epshit dhe risive:

- a) paraqitja e argumentit dhe
- b) largimi(shmangia) i dyshimit.

Pengesat e Tekfirit të pasuesve të epshit dhe risive:

- a) Mosardhja e teksteve që e obligojnë njohjen e së vërtetës,
- b) ose nëse tekstet kanë ardhur, te ai nuk janë "autoritative" (nuk janë të besueshme, të forta),
- c) ose janë autoritative, por i kundërshton diçka, që te ai e detyron në Te'wil (ndaj teksteve),
- d) ose janë autoritative, por nuk i ka kuptuar (nuk ka qenë i aftë për t'i kuptuar),
- e) ose e ka penguar ndonjë dyshim, me të cilën Allahu e arsyeton,
- f) ose nëse është muxhtehid me nijjet të mirë,
- g) ose është mukal-lid në tentim për njohjen e së vërtetës.

Kurse gabimi (paqartësia, iluzioni) paraqitet për shkak të mangësisë në kërkim të së vërtetës ose mosplotësimin në të kuptuar, ose për shkak të të dyjave.

Ai që ka qenë Muxhtehid në të kërkuarit e së vërtetës dhe ka gabuar, Allahu do t'ia falë gabimin, qoftë ai gabim prej çështjeve teoriko-shkencore apo praktike, edhe atë sipas Ixhmasë.

Kurse, sa i përket atij që i ka bërë mëkat Zotit të tij, ka pasuar epshin e tij dhe nuk ka dhënë mund për ta kuptuar të vërtetën, por ka folur pa dituri, ai është Asija (i padëgjueshëm), mëkatar, dhe pas kësaj është e mundur që mbi atë person të realizohet kërcënimi, ose të mos realizohet, për shkak të pengesave që e pengojnë atë (kërcënimin).⁴³

Kaptina e emërimit të pengesave që e mundësojnë realizimin e kërcënimit

Pengesat që e realizojnë kërcënimin ndaj mëkatarëve Asija (të padëgjueshëm) dhe risimtarëve të mashtruar/zhgënjyer, janë me sa vijon:

- a) teube(pendimi) e singertë,
- b) veprat e mira që i fshijnë ose i mbipeshojnë të këqijat,
- c) sprovat, për shkak të të cilave do t'i falen mëkatet,
- d) shefati i ndërmjetësuesve i cili do të pranohet,
- e) mëshira e të Gjithmëshirshmit...

...edhe të tjerë që hyjnë nën kuptimin e asaj që e përmend. E atëherë kur nuk do të jenë këto pengesa, kërcënimi do t'i arrijë mëkatarët dhe risimtarët, dhe ajo nuk do të largohet përveç rastit të atij që ka ikur nga Zoti i tij, ashtu siç ik deveja nga pronari.⁴⁴

Kaptina e emërimit të kushteve të ngritjes së argumentit dhe sqarimit të kuptimit të saj

1) Argumenti i Allahut ndaj robërve të Tij ngritet me dy gjëra: ⁴⁵

⁴² Shiko "Mexhmu'atul-Fetawa" 18/54, 7,12, 535, 491, "Minhaxhut-Te'sis" të dijetarit Abdul-Latif Ali shejh, "Fethul-Bari" 2/297, "Ed-Durerus-Senijje" 10/355, 333, 332, 11/449, "Ixhma'us-Sunnet", fq.146

⁴³ Shiko "Mexhmu'atul-Fetawa" 12/180, 500, 497, 19/217, 12/494, 20/25, "Et-Temhid" të Ibn AbdilBerra 9/145

⁴⁴ Shiko "Mexhmu'atul-Fetawa" 12/180, 20/254, "El-Kawa'id vel-Fewa'idul-usulijje" fq. 52,53

- a) Ardhjes së Kur'anit dhe peygamberit dhe
 b) mundësia për të arritur deri te ata (dy) – d.m.th. deri te Kur'ani dhe Sunneti

Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

"...në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërhek vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet." (El-En'am, 19)

"Ne nuk dënojmë asnjë popull, para se të çojmë të dërguar!" (El-Isra, 15)

"(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve." (En-Nisa, 165)

dhe fjalët e të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem:

*"Askush nuk e do arsyetimin më shumë se Allahu, prandaj ka dërguar peygamberë si sjellës së lajmeve të mira dhe paralajmërues."*⁴⁶

*"Nuk ka askush prej këtij ummeti që dëgjon për mua, as jehudi dhe as nasranij(i krishterë), e pastaj vdes duke mos besuar në atë me të cilën jam dërguar, e që të mos jetë prej banorëve të zjarrit."*⁴⁸

Në lidhje me këtë ka ixhma të ehli-sunnetit, se Allahu ka dërguar peygamberë që t'i përkujtojnë njerëzit për premtimin që Allahu e ka marrë prej tyre. Këtë e shohim në fjalët e Tij swt:

"Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: A nuk jam Unë Zoti juaj? Ata u përgjigjën: Po, dëshmojmë se Ti je. Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: Këtë nuk e kishim ditur ose që të mos thoni: Me të vërtetë, etërit tanë ishin idhujtarë para nesh, kështu që edhe ne jemi pasardhësit e tyre. A mos vallë do të na shkatërrosh për veprat e atyre që ndoqën mashtrimin? " (El-A'raf, 172-173)

Në këtë drejtim, pas asaj, ka treguar në dërgimin e Peygamberëve, me fjalët:

"Kështu, Ne i shpjegojmë hollësisht ajetet, që ata të kthehen (në rrugën e drejtë)." (El-A'raf, 174)

Kurse spjegimi i detajizuar s'bëhet ndryshe, përveç rrugës së të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, ashtu që njerëzit ti kthehen asaj për të cilën janë krijuar dhe të cilën e kanë vërtetuar më herët. Ka thënë i Lartësuar:

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Er-Rum, 30)

Ka thënë i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem:

*"Çdo fëmijë lind në 'fitre', e pastaj prindërit e bëjnë jehudi, të krishterë, zjarrputist ose mushrik."*⁴⁷

Nga këtu rrjedh se deri te cilido (njeri) qoftë që arrin Kur'ani ose dëgjon për të dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, dhe është *mukel-lef* (i obliguari në bazë të Sheriatit) dhe ka mundësi të nxë dituri, dmth është i rritur, i kuptueshëm, i aftë të pyesë dhe t'a dëgjojë përgjigjen, dhe nuk i duhet përkthyes si të huajit, të shurdhtit ose memecit, të cilët nuk gjejnë rrugë deri te njohja e së vërtetës - ndaj tyre është ngritur argumenti.

Thotë i Lartësuar:

⁴⁵ "El-Fetawa" 16,166, 28/125, "Er-Redd galel mentikijjin", fq.99, "Ed-Durerus-Senijje", 11/72, "Tefsir" të Ibn Xheririt dhe Ibn Kethirit të ajetit 19 nga sureja el-En'am dhe ajetit të sures el-Isra, "Tefsir" i Ibn Kethirit, ajeti 72, 73, 74 të sures el-A'raf

⁴⁶ Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga el-Mugire ibn Shugbe, radijallahu anhu

⁴⁷ Muslimi

"Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për tu shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit). Allahu e shpie në humbje kë të dojë dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (Ibrahim,4)

"Thuaju: "Allahu ka argumentin më bindës dhe, po të donte Ai, të gjithëve do t'u udhëzonte në rrugë të drejtë!" " (El-En'am, 149)

"Po,⁴⁸ është i domosdoshëm sqarim i detajuar për këtë çështje, pas të cilit do të humbet(largohet) problematika; e kjo është dallimi në mes mukal-lidit, që ka qenë në gjendje ta mësojë dhe ta njeh të vërtetën, por ia ka kthyer shpinën asaj(është larguar prej saj) dhe mukalidit që në asnjë mënyrë nuk ka qenë në gjendje ta bëjë atë. Dhe të dy këto lloje ekzistojnë në realitet. Ai që ka qenë në gjendje (mutemekinn) dhe është larguar (ka kthyer shpinën - mu'rid) –neglizhent dhe lënë s obligimit, prandaj nuk ka arsyetim te Allahu. Ndërsa, sa i përket atij që nuk është në gjendje të pyes dhe të mësojë, atij që në asnjë mënyrë nuk ka mundur të fitojë dituri - të tillët poashtu ndahen në dy grupe:

Grupi i parë: ai i cili e dëshiron udhëzimin, i jep përparësi atij, e do atë, por nuk ka forcë për ta gjetur, as për ta kërkuar, për arsye se s'ka kush e udhëzon; gjykimi për të është sikurse gjykimi për ehlul-fetri dhe ata të cilëve nuk u ka ardhur daweti(thirrja)."

Grupi i dytë: neglizhent(i lëgjërat pas dore), i cili nuk ka vullnet dhe as që i bie ndërmend(kujtohet) diçka tjetër jasht asaj në të cilën është.

Kështu, ai i grupit të parë thotë: O Zoti im! Po të dija ndonjë fe më të mirë se ajo në të cilën jam, do të nënshtrohesha Ty me të dhe do t'a lija atë në të cilën jam, por nuk di tjetër, përveç këtë të cilën e kam dhe nuk kam forcë të vepojë ndryshe. Ky është kulmi(maksimumi) i mundit tim(çka mund të bëj) dhe fund i njohjes sime.'

Kurse, i dyti është i kënaqur me atë në të cilën është, nuk i jep përparësi asgjëje pos asaj dhe as që shpirti i kërkon diçka tjetër pos saj dhe te ai nuk ka dallim mes gjendjes kur mund të bën diçka dhe gjendjes kur nuk mundet.

Të dytë janë të dobët(të pamundshëm), por këtë të dytin nuk e bëjmë të barabartë me të parin, për shkak të dallimeve mes tyre.

I pari është sikur ata që e kërkojnë fenë në fetre, por nuk e kanë gjejnë, prandaj e lënë këtë tentim pas investimit të mundit maksimal në kërkimin e tyre, për shkak të pamundësisë dhe padituriës.

Kurse, i dyti është sikur ai që nuk ka kërkuar dhe ka vdekur në Shirk, edhe pse edhe po të kërkonte ka qenë e pamundur ta gjejë të vërtetën.

Pra, dallimi qëndron në mes pamundësisë së atij që e kërkon të vërtetën dhe pamundësisë së atij që nuk interesohet(e kthen shpinën dhe largohet).⁴⁹

Kaptina rreth asaj se emri dhe gjykimi janë të ndarë para ngritjes së argumentit, por bashkohen pas saj

1) Allahu i ka ndarë disa emra dhe gjykime para shpalljes (me tekst), por pas saj i ka bashkuar. Shi kështu, ngritja e argumentit nuk i ndërron emrat e shariatit të asaj që Ligdhënësi e ka quajtur shirk, kufr ose fisk, edhe pse vepruesi i tyre nuk dënohet nëse ndaj tij nuk është ngritur argumenti ose nuk ka arritur thirrja(daweti).

Në këtë kuptim emri mushrik është vërtetuar para ardhjes së Pejgamberit, sepse ai i përshkruan shok Zotit të tij dhe e bën dikë tjetër të barabartë me Të. Dhe çdo dispozitë që ka të bëjë me emrat fetarë, si *islam, iman, kufr, nifak, riddet, pranim i Jehudizmit, Krishterimi, me të drejtë ligjore është konstatuar në rastin e atij që është karakterizuar(përshkruar) me atributet detyruese.*

a) Shembull i "emrit" është: *musliman, kafir, mushrik...etj.*

⁴⁸ "Tarikul-Hixhretejn", kategoria e 17-të, "Medarixhus-salikin", "Kaptina e dëgjimit dhe dituriës", "Minhaxhut-Te'sis", fq. 99-223, "Keshfush-Shubhetejn" të dijetarit të madh Sulejman ibn Sehman, fq. 91

⁴⁹ Shiko "Tarikul-Hixhretejn", kategoria e 17-të, "Minhaxhut-Te'sis" të dijetarit të madh Abdul-Latif ibn Abdir-Rahman Ali shejh, fq. 316 dhe "Mexhmu'atul-Fetawa" 35/220-227, 20/37-38

I Lartësuar ka thënë:

“Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi.” (En-Naziat, 17)

Allahu e ka quajtur faraonin “tagij” para se t’i vjen Musai, alejhis-selam.

Kur tregon Allahu për Belkisën dhe popullin e saj para se t’u arrin atyre letra e Sulejmanit, alejhis-selam, thotë:

“...ajo ishte nga populli mohues.” (En-Neml, 43)

Dhe ka quajtur kafira për shkak të kufrit dhe shirkut që kanë bërë.⁵⁰

b) Gjykim është ajo që lidhet për ato emra dhe dispozita, në kuptimin e ekzistimit dhe mosekzistimit.⁵¹

Gjykimet ndahen në:

Gjykime lidhur me këtë botë, si bërja hallall e gjakut, nderit, miqësimi dhe armiqësimi, etj, si dhe

Gjykime lidhur me ahiretin, si shpërblimi dhe dënimi. Allahu i Lartësuar thotë për faraonin, pasiqë e shpalli rrenacak Musain a.s :

“...por Faraoni nuk e dëgjoji të Dërguarin, andaj i çuam denim të rëndë.” (El-Muzzemil ,16)

Poashtu na tregon se Sulejmani, alejhis-selam ka pasur për qëllim ta dënojë Belkisën dhe popullin e saj dhe nuk i ka arsyetuar për Kufirin e tyre pas arritjes së letrës së tij te ata duke thënë:

“Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata dhe, me siguri, do t’i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përulur.” (En-Neml, 37)

Kështu bëhet e qartë se ai që bën *Shirk* – quhet *Mushrik*, sepse kjo ka ndodhur nga ana e tij, dhe nuk ka mundësi në asnjë mënyrë t’a mohojmë prej tij, me atë që kjo nuk e tërheq me vete dënimin e tij, sepse *Shirku* dhe *Kufri* janë emra për qortimin e veprave dhe në mes tyre⁵² nuk ka domosdoshmërisht lidhje shkakore, edhe pse ekziston “iniciatori” dhe shkak i tij (për këtë), sepse ekziston pengesa – e kjo është mosngritja e argumentit dhe mosardhja e shpalljes (tekstit), pas të cilave vjen në shprehje dënimi.

Pra, ka dallim mes Kufirit pas të cilit nuk pason dënim dhe i cili ndodh para ngritjes së argumentit dhe kufirit pas të cilit pason dënim dhe bëhet pasi të ngritet argumenti. Edhe ky rregull paraqet një bazë të madhe që duhet patjetër të kuptohet dhe t’i kushtojmë rëndësi.⁵³

Kaptina rreth gjykimit (dispozitave) lidhur me jetën (gjakun) e pabesimtarëve dhe emërimin e kushteve të Xhihadit

1) Esenca është se *jeta* e njeriut është e mbrojtur. Edhe *gjaku* i pabesimtarëve në fillim të islamit ka qenë i mbrojtur *me mbrojtjen themelore, fillestare* dhe me ndalesën e Allahut *drejtuar besimtarëve* që mos t’i mbysin.

Allahu, subhanehu ve tegala, thotë:

“A nuk i ke parë (o Muhamed) ata që janë porositur: Tërhiqni duart tuaja nga lufta... ” (En-Nisa,77)

⁵⁰ Shiko “*Mexhmu’atul-Fetawa*” 20/37,38, 12/496 dhe “*Komenti i Wasitijes*” te fjala e Shejhut “*Asma’ud-din*”

⁵¹ Dmth në kuptim të ekzistimit ose mosekzistimit të esencës të cilën Ligjvënësi e ka emëruar me emra të caktuar dhe për ato emra ka lidhur dispozita të caktuara (sh.p)

⁵² Dmth emrat dhe dispozitat e dënimit (sh.p)

⁵³ “*Mexhmu’atul-Fetawa*” 20/37, 2/78, “*Tefsir*” i Ibn Xheririt në suren Neml, ajeti 43, “*Der’u Te’arudil-Akli wen-Nakl*” 8/490-492, “*Beda’iut-Tefsir*” të Ibn Kajjimit 2/184

Kurse, i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

"Ende nuk jam i urdhëruar të luftoj."

Sikur jeta e Koptit të cilin e vrau Musa a.s, poashtu edhe gjakut të jobesimtarëve deri te të cilët nuk ka arritur Daweja(thirrja për Islam) në kohën tonë, sepse Musa a.s këtë e ka futur në grupin e mëkateve në Dunja dhe Ahiret, duke pasur parasysh se ardhja e Dawetit paraqet – "kërkesë për pendim të përgjithshëm" nga çdo Kafir(jobesimtar).

Dhe ne nuk e lejojmë vrasjen e asnjë kafiri para se të kërkojmë prej tij të pendohet, për shkak se vrasja e atij deri te i cili nuk ka arritur thirrja(daweti), nuk është e lejuar. Argument për këtë janë fjalët e Allahut:

"Thuaju atyre që nuk besojnë: nëse largohen (nga mosbesimi), do t'u falet e kaluara..." (El-Enfal, 38)

Ky është kuptimi i kërimit të pendimit.

Xhihadit kundër pabesimtarëve duhet t'i paraprijë thirrja e tyre, sepse nuk dënim, përveç ndaj atyre që u ka arritur thirrja(daweti), duke marrur për argument hadithin e gjatë të Burejdit të cilin e transmeton Muslimi, ku pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, pasi që e përmend urdhërin për luftë kundër pabesimtarëve, thotë:

"Dhe kur t'a takosh armikun tënd prej mushrikëve, thirri në tri gjëra..."

- deri te fjalët:

"...e pastaj thirri(ftoi) nëIslam."

Kur e takojmë armikun tonë ne e ftojmë atë në islam. Nëse ai refuzon, atëherë i ofrojmë të jep xhizjen dhe nëse përsëri refuzon me ndihmën e Allahut luftojmë kundët tij, për shkak të hadithit të Burejdit.

Mirëpo, nëse Daweti(thirrja) është përhapur dhe për të e di(ka njohuri) i afërti dhe i largëti dhe ne jemi të bindur për këtë (e kemi vërtetuar këtë gjendje), atëherë do t'i sulmojmë në të gjitha gjendjet, sepse...

"...i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, e ka sulmuar (fisin) Benul-Mustalak në befas, pastaj i ka mbytur luftëtarët e tyre dhe i ka robëruar gratë dhe fëmijët e tyre."⁵⁴

E kjo nuk ndodh ndryshe përveç pas ndarjes së tërësishme në mes dy partive (palëve) dhe dallimit në mes dy territoreve – *Darul-kufrit* dhe *Darul-islamit*. Në të kundërtën, është e pamundur të luftohet kundët tyre, për shkak të fjalëve të Allahut:

"Vërtet, ata që besuan dhe ata që u shpërngulën e luftuan në rrugë të Allahut..." (El-Bekare, 218)

Ibn Kajjimi, duke folur për shkallët e xhihadit në *"Zadul-Mead"* thotë:

"Nuk bëhet Xhihadi ndryshe, përveç se me Hixhret, kurse nuk bëhet Hixhreti dhe Xhihadi ndryshe, përveç se me Iman."

Për sa i përket "ndarjes", dhe nga shkak i ndalimit të Allahut që besimtarët të luftojnë kundër Mekkasve, sepse ka ekzistuar pengesa për luftë, e kjo ka qenë ekzistimi i burrave dhe grave besimtare që kanë jetuar në mesin e Mushrikëve e që nuk kanë qenë të ndarë në vendbanime(mëhalla etj) në të cilat nuk do t'u vinin telashet (dmth ku do të kishin qenë të mbrojtur nga telashet). Për shkak të kësaj ka thënë:

"Po të mos kishte qenë për disa besimtarë e besimtare (në Mekë) që ju nuk i njihnit e kështu mund t'i merrnit nëpër këmbë, duke bërë gjynah kundrejt tyre pa e ditur, Allahu do t'u kishte urdhëruar t'i luftonit ata. Sikur ata të ishin të veçuar, Ne do t'i ndëshkonim me dënim të dhembshëm ata (banorë të Mekës), që nuk besuan." (El-Feth, 25)

Këtë e ka arsyetuar me mosndarjen dhe mosdallimin. Për këtë shkak vëri re kësaj baze, sepse shumica, duke mos e marrur parasysh këtë gjë, kanë devijuar në lidhje me (këtë mesele) luftën kundër pabesimtarët dhe Xhihadit kundër tyre.

⁵⁴ Transmeton Buhari

Poashtu fjalët e të Lartmadhëruarit:

“Edhe ata që u bënë besimtarë më vonë, që u shpërngulën dhe luftuan bashkë me ju, janë vëllezërit tuaj...” (El-Enfal, 75)

Ka sqaruar Allahu se ai që ka besuar nuk ka qenë i aftë të bëjë Xhihad, përveçse pas Hixhretit. Poashtu, kushtoi vëmendje fjalës së Allahut:

“...me ju...”

... d.m.th. pasi që ka bërë Hixhret, ku Allahu qartë e ka lidhur Xhihadin me Hixhretin.

Poashtu, fjalët e Allahut:

“Kur ju ishit në bregun e afërt të luginës, ata ndodheshin në bregun e largët...” (El-Enfal, 42)

Sidoqoftë, ajetet rreth kësaj teme janë aq të shumtë, sa s'ka nevojë të përmenden të gjitha dhe gjithashtu janë të qartë për secilin që mendon rreth tyre.⁵⁵

Kaptina e spjegimit të llojeve të territoreve dhe dispozitave lidhur me banorët e tyre

Territoret ndahen në dy grupe, pa të tretën:

a) *Darul-kufr*, - Vendi i Kufrit, sikur Mekka para pejgamberisë dhe pas saj.

Ka thënë Allahu, subhanehu ve teala:

“...Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! ” (En-Nisa, 75)

“...do t'ju tregoj shtëpinë e të pabindurve.” (El-Agraf, 145)

b) Dhe *Darul-islam*, - Vendi i Islamit, sikur Medina pas Hixhretit, sepse Hixhreti prej Meke në Medine ishte obligim.

Ka thënë Allahu, subhanehu ve teala:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë...” (El-Hashr, 9)

...derisa s'ka qenë çliruar Mekka, pas së cilës i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Nuk ka Hixhret pas çlirimit, por ka xhihad dhe nijjet.”⁵⁶

Pra, *darul-islam* është vendi ku sundojnë(zbatohen) ligjet e Islamit, edhe nëse shumica e banorëve të tij janë kafira, siç ishte Medina në fillim para anulimit(të marrëveshjes) dhe përzënies apo persekutimit të Jehudive. Poashtu, vende të tilla kanë qenë Jemeni, Nexhrani, Bahrejni dhe Shami në kohën e Omerit, radijallahu anhu.

Kurse, *darul-kufr* është vendi ku sundojnë(zbatohen) ligjet e kafirave, edhe nëse shumica e banorëve të atij vendi janë muslimanë, sikur që ishte rajoni i Ubejdive të cilët e pushtuan Misirin, Shamin dhe Magribin.

Nga kjo kuptojmë se çdoherë kur forca është te kafirat, ata sundojnë dhe i zbatojnë dispozitat e tyre, kurse kur forca është në duart e muslimanëve është e patjetërsueshme që dispozitat e tyre të jenë më të lartat.

Siç shihet, gjykimi lidhet me “më të fortin”, jo me “të mposhturin”.

⁵⁵ “*Es-Sarimul-Meslul*” fq.104, “*Es-Safedije*”, fq. 317-323, “*Es-Sarimul-Meslul*”, fq. (321, 325, 323), “*Komenti i kaptinës për atë se çka ka përcjellur për thirrjen në Shehadet La Ilaha Ilallah në Kitabut-Tewhid*”, “*Mexhmu’atul-Fetawa*” 9/245, 280, 252, 253, “*Zadul-Me’ad*” 3/71, 50, 108, 160, “*Ed-Durerus-Senijje*” 8/240, 241, 9/253

⁵⁶ Muttefekun alejhi prej Ibn Abbasit, radijallahu anhu

Gjendjet e “vendeve” janë sikur gjendjet e robërve (njerëzve). Ndonjëherë janë të besimtarëve, e ndonjëherë të pabesimtarëve, nga shkak se karakteri (përshkrimi) i tyre është i kalueshëm dhe nuk është i pandashëm, kurse dispozita është, në aspektin ekzistencial dhe në atë të mosekzistimit - i lidhur, dmth rrotullohet me shkakun e vet (për shkak të të cilit është i gjykuar).

Mirëpo, nëse udhëheqësit bien në kufr dhe me atë rast nuk i zbatojnë ligjet e jobesimtarëve në vendet ku sundojnë dhe as që pengojnë të realizohen (kryhen) dispozitat (obligimet) Islame, kurse besimtarët janë të tubuar rreth së vërtetës dhe me këtë e shprehin fenë e tyre dhe askush nuk i pengon, atëherë në këtë rast vendet e tilla mbeten të jenë *darul-islam*, për arsye se nuk zbatohen ligjet e kafirave në ato, por është obligim rrëzimi i sunduesit felëshues dhe zëvendësimi i tij me tjetër, nëse është e mundur të bëhet kjo pa dëme dhe intriga (tolllovira).

Darul-kufr ndahet në:

- a) vendi i pabesimtarëve të cilët e kanë statusin e luftëtarëve (*harbijjun*)
- b) vendi i atyre me të cilët ka marrëveshje për paqë (*mu'ahedun*).

Shembull për *harbijjun* janë Mekkasit para marrëveshjes së Hudejjes, kurse shembull për *mu'ahedun* janë Mekkasit pas marrëveshjes së Hudejbijes.

Sa i përket *ehludh-dhimmes*,⁵⁷ vendi i tyre është *darul-islam*, sepse ata gjenden nën sundimin e muslimanëve dhe nën mbrojtjen e tyre dhe me marrëveshje ata janë të sigurt. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka marrë xhizje prej jehudëve dhe krishterëve:

“...derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përlulur.” (Et-Teube, 29)

... ashtu siç ka marrë xhizje edhe prej *Mexhusive të Hexhrit*.^{58 59}

Kaptina rreth obligimit të hixhretit dhe sqarimit të dispozitave të tij

Nëse ekzistojnë të dy vendet, është obligim të bëhet hixhret prej *Darul-kufrit* në *Darul-islam*.

“Hixhret në gjuhë do të thotë shpërngulje prej një vendi në tjetër, kurse në shariat do të thotë shpërngulje prej vendit të shirkut dhe mëkateve në vendin e islamit dhe nënshtrimit. Dhe prej çdo vendi ku njeriu nuk mund ta shpreh fenë e tij, e ka për obligim ta len atë vend dhe të bën hixhretin në vendin ku mundet ta shpreh fenë e tij.”⁶⁰

Allahu, subhanehu ve te'ala ka thënë:

“Thuaj: Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” (Et-Teube, 24)

“Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: Ku ishit? Ata përgjigjen: Ishim të pafuqishëm në Tokë. (Engjëjt) do t'u thonë: A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të? Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi, eh sa i keq është ai vendbanim!” (En-Nisa, 97)

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

⁵⁷ dmth dhimmij, Jehudë, Krishterë dhe Mexhusi të cilët jetojnë në shtet islam dhe paguajnë xhizje dhe janë nën mbrojtjen e shtetit islam

⁵⁸ Transmeton Buahriu nga AbdurRahman ibn Aufi, radijallu anhu

⁶² “*Ed-Durerus-Senijje*” 9/257, 248, 428, 8/261-263, 491, 497, “*Ixhma’u Ehlis-Sunneti vel-Xhema’ah*”, fq. 93., “*Mexhmu’atul-Fetawa*” 18/281-284, 27/53, 45, 35/139, “*Ahkamu Ehlihdh-Dhimmeh*”, të Ibn Kajjimit, fq. 269, “*Tefsiri i Sa’dit*” të sures el-Hashr, ajeti 9, “*Zadul-Me’ad*” 3/108

⁶³ Fjalët e Sa’d bin Atik

"Unë jam i pastërt prej(çdo) muslimani që jeton në mesin e mushrikëve..."

Në një hadith thuhet:

"...nuk iu dallohen zjarret..."

Kurse në një tjetër thuhet:

"...kush është në 'bashkësi' me mushrikun dhe banon me të, është i njëjtë si ai."

Të gjitha këto hadithe gjenden në *"Sunenet"* dhe nëse njeriu e lë hixhretin, atëherë kur ka mundësi ta kryen, ai bën mëkat me ixhma (pajtimin e gjithë dijetarëve), kuse nëse njeriu është në gjendje ta shpreh fenë e tij, atëherë hixhreti për të është *mustehab* (e pëlqyer). Argument për këtë janë fjalët e të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, në hadithin e gjatë të Burejdit:

"Urdhëroi që t'a lënë rajonin e vet(dhe të shkojnë) kah Daru Muhaxhirët. E nëse kundërshtojnë – lajmëroji se janë sikur Muslimanët beduinë."⁶¹

Ndërsa, sa i përket "të shtypurve", ata janë që për shkak të dobësisë së tyre dhe mospasjes mbrojtje nuk janë në gjendje ta shprehin fenë e tyre dhe as nuk janë në gjendje të bëjnë Hixhret për shkak se janë të dobët dhe të paafët. Të këtillet Allahu i ka përjashtuar në fjalët:

"Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë." (En-Nisa, 98)

Dhe në Ajetin tjetër:

"Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të Allahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Yte dikë që të na ndihmojë!" (En-Nisa, 75)

Pra, ata nuk kanë mundësi të dalin. Por, edhe po të mund të dilnin, ata nuk do të mund ta gjenin rrugën. Krahas kësaj, ata i luten Zotit të tyre që t'i nxjerrë prej *darul-kufris* në *darul-islam* dhe t'u ndihmojë me ndihmës dhe mbrojtës, të cilët do t'i nxjerrin(shpëtojnë) prej duarve të pabesimtarëve.

Ndërsa, atëherë kur të përhapen risitë dhe mëkatet në *darul-islam*, përcaktohet hixhreti në *darus-sunneh* dhe *darul-iman*, e nëse nuk ekziston *darul-islam*, obligim është hixhreti në të keqen më të vogël nga dy të këqija, për shkak të 'vendosjes' së fesë dhe të punuarit sipas saj, ashtu siç ka qenë urdhëri i të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, drejtuar shokëve të tij të bëjnë Hixhret në Abisini i cili ishte vend i krishterëve në atë kohë duke iu thënë se aty është një mbret, te i cili askujt nuk i bëhet padrejtësi.

Ndërsa, Allahu ka thënë:

"O robërit e Mi, që keni besuar! Toka Ime është vërtet e gjerë, andaj më adhuroni vetëm Mua!" (El-Ankebut, 56)⁶²

Me këtë do të realizohej ajo që e kemi dëshiruar, kurse salavatet dhe selamet qofshin mbi Muhammedin, salallahu alejhi ve selem, familjen e tij dhe të gjithë shokët (as'habët) e tij.

⁶¹ Muslimi

⁶² *"Ed-Durerus-Senijje"* 8/496, 10/140, *"Mexhmu'atut-Tewhid"* 1/371, *"Tefsiri i Ibn Xheririt"*, ajeti 23 i sures et-Tewbe, ajeti 93 i sures en-Nisa në *"Tefsirin e Ibn Kethirit"*, *"Ed-Durerus-Senijje"* 8/428, 290, 429, 9/258, *"Mexhmu'atut-Tewhid"* 1/366-375, *"Ed-Durerus-Senijje"* 8/291, 457, 9/258, *"Mexhmu'atul-Fetawa"* 28/291, *"Tefsiri i Ibn Xheririt"*, ajeti 56 i sures el-Ankebut dhe *"Tefsiri i Sagdit dhe Ibn Kethirit"*